



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-4
10.09.2026
Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹, neni 24 dhe neni 79, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe nenin 51, paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), në pajtim me nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 dhe nenin 59, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.01-3632/1 të datës 22.08.2025, duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup (PA1 nr.ynë.08-4 të datës 01.09.2026), gjatë seancës së 30-të e mbajtur më 10.09.2026, në pajtim me Konkluzionin, (nr.ark.02-3348/3 të datës 10.09.2026), miratoi:

VENDIM
për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive
Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup

1. Leja për transmetim televiziv e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup, (PA1 nr.08-4 të datës 07.09.2023), i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

2. Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me pikën 1 të këtij Vendimi, do t'i lëshojë leje të re Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup, për periudhën për të cilën vazhdohet leja, është e detyruar të punojë në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin e Mediave, dispozitat e miratuara në bazë të tyre, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

5. Padia nuk e pezullon zbatimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

Në nenin 79 (Kohëzgjatja e lejes për transmetim televiziv ose radio) paragrafi (1) nga Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele – LShMAAV, përcaktohet, se leja për transmetim televiziv ose radio e shoqërive tregtare radiodifuzive dhe institucioneve radiodifuzive jofitimprurëse, jepet për periudhë kohore prej nëntë vitesh, me mundësi vazhdimi.

Në pajtim, me nenin 79, paragrafi (2) të LShMAAV-së, leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Leja për transmetim televiziv ose radio në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV-së, mund të vazhdohet me kërkesë të mbajtësit të lejes për një periudhë prej nëntë vitesh. Kërkesa dorëzohet në Agjenci në afat prej gjashtë muajsh para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Këshilli i Agjencisë miraton detyrimisht vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për vazhdimin e lejes, me kusht që transmetuesi të mos ketë kryer shkelje në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

Në pajtim me nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë miraton vendim për refuzimin e kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe atë:

- së paku tre herë gjatë kohëzgjatjes së lejes ka vepruar në kundërshtim me ndalesat e veçanta të nenit 48 të Ligjit, për të cilat ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme ose
- gjatë kohëzgjatjes së lejes, së paku në një cikël zgjedhor, mbulimi mediatik nuk është realizuar në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshëm, për të cilat ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Televizioni SITEL SHPKNJ P Shkup (SITEL), është mbajtëse e Lejes për transmetim televiziv, (PA1 nr.08-4 datë 07.09.2023), me vlefshmëri prej 3 (tre) vitesh, duke filluar nga data 05.01.2024 deri më 04.01.2027 për transmetim përmes kapaciteti transmetues të multipleksi digjital tokësor, në nivel shtetëror, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues në gjuhën maqedone.

Në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), është publikuar formulari i Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA dhe shtojcat e kërkesës, dhe atë:

- Dokumenti përkatës si dëshmi se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie-ndalesë për kryerjen e veprimtarisë nga regjistri ose evidenca (origjinal ose kopje e noterizuar, jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit), ose deklaratë e noterizuar nga drejtuesi i transmetuesit se nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit);

- Deklaratë e noterizuar nga transmetuesi, se do të respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike e RMV-së (AKE), në pajtim me Ligjin e Komunikimeve Elektronike (LKE) dhe dispozitat e nxjerra në bazë të Ligjit; do të respektojë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga Agjencia; nuk shkel dispozitat nga Kapitulli IV i LShMAAV-së dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të vërteta dhe të vlefshme, si dhe

- Pëlqim për përpunimin e të dhënave personale të cituara në Kërkesë.

Me datë 01.09.2026, SITEL, në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV-së, ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv (PA1 nr ynë.08-4 datë 01.09.2026) në formularin përkatës. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se ajo është e rregullt dhe e plotë dhe i përmban shtojcat e nevojshme, dhe atë:

- Pëlqim i datës 31.08.2026, për përpunimin e të dhënave personale të cituara në Kërkesë, e dhënë nga drejtuesi i transmetuesit, Shtojcë nr.2.1. - Deklaratë e noterizuar nga Goran Gligorov e dhënë në cilësinë e drejtuesit të SITEL se transmetuesi do të respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me LKE dhe dispozitat e miratuara në bazë të ligjit; do të respektojë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga Agjencia; nuk shkel dispozitat nga Kapitulli IV i LShMAAV-së dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të vërteta dhe të vlefshme (UZP nr.5821/2026 datë

01.09.2026), Shtojcë nr.2 – Deklaratë e noterizuar nga Goran Ivanovski, e dhënë në cilësinë e themeluesi/pronar i Shoqërisë për Tregti MONTEKO ShPKNJ P eksport-import Shkup, në cilësinë e themeluesi/pronar i vetëm i transmetuesit SITEL, se transmetuesi në fjalë do të respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me LKE dhe dispozitat e mxjerra në bazë të ligjit; do të respektojë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga Agjencia; nuk shkel dispozitat nga Kapitulli IV i LShMAAV-së dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të vërteta dhe të vlefshme (UZP nr.5808/2026 datë 31.08.2026), dhe dekratë përkatëse si dëshmi se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie-ndalesë për kryerjen e veprimtarisë nga regjistri ose evidencë, dhe atë: Vërtetim për dënim të kryer me numër 0808-50/150020260340069 të datës 31.08.2026, lëshuar nga Regjistri Qendror i RMV-së, se për transmetuesin nuk janë evidentuar të dhëna për shqiptimin e dënimi të kryer për vepra penale – ndalesë të përhershme për kryerjen e veprimtarisë së veçantë, Vërtetim për dënim me numër 0808-50/150020260340068 të datës 31.08.2026 e dhënë nga Regjistri Qendror i RMV-së, se ndaj transmetuesit nuk janë të evidentuar të dhëna për shqiptimin e masës për vepra të kryera penale – ndalesë të përkohëshme për kryerjen e veprimtarisë së veçantë dhe Vërtetim për sanksion kundërvajtës me numër 0808-50/150020260340001 të datës 31.08.2026, e dhënë nga Regjistri Qendror i RMV-së, se ndaj transmetuesit nuk janë evidentuar të dhëna për shqiptim të saknksionit kundërvajtës – ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrimit.

Pas mbikëqyrjes së kryer mbi punën e transmetuesit gjatë kohëzgjatjes së lejes, Agjencia ka konstatuar se kërkuesi – SITEL i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 79 të LShMAAV-së, përkatësisht se gjatë kohëzgjatjes së Lejes, PA1 nr.08-4 të datës 07.09.2023, nuk ka kryer shkelje serioze të cekura në nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV-së.

Duke marrë parasysh sa më sipër, drejtori i Agjencisë, i dorëzoi Këshillit të Agjencisë, Propozimin, (PA1 nr.08-4 datë 09.09.2026, për miratimin e vendimit për vazhdimin e Lejes për transmetim televiziv të SITEL, (PA1 nr.08-4 datë 07.09.2023, vlefshmëria e së cilës skadon më 04.01.2027, me propozim që e njëjta të vazhdohet për kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh, përkatësisht për periudhën nga data 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10, nenit 24 dhe nenit 79, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LShMAAV-së, nenit 51, paragrafët 1 dhe 2 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në pajtim me nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 dhe nenin 59, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë, duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizioni SITEL ShPKNJ P Shkup (PA1 nr ynë.08-4 datë 01.09.2026), Këshilli i Agjencisë miratoi Vendimin si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Agjencisë. SITELIT për vazhdimin e lejes nga pika 1 e këtij Vendimi, Agjencia do t'i lëshojë leje të re. Transmetuesi është i detyruar që gjatë periudhës për të cilën vazhdohet leja, të punojë në pajtim me LShMAAV-së, Ligjin e Mediave, dispozitat e miratuara në bazë të ligjit, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje. Padia nuk e pezullon zbatimin e Vendimit.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, transmetuesi nga pika 1 e këtij Vendimi, ka të drejtë të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.